



Kontrollimi i Parasë në Politikë

Hyrje

| 2022

Kontrollimi i Parasë në Politikë

Hyrje

Dr. Magnus Ohman

Këshilltar i Lartë Politikë- Financiar i IFES-it



**Center for Anti-Corruption
& Democratic Trust**

E drejtë e autorit © 2022 Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklarata e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose mjet, elektronik ose mekanik, duke përfshirë fotokopjen, regjistrimin ose çdo sistem të ruajtjes dhe rikthimit të informacionit pa lejen me shkrim të IFES-it.

Kërkesat për leje duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- Një përshkrim i materialit për të cilin dëshirohet kopja.
- Qëllimi për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra në të cilën do të përdoret.
- Emri i juaj, titulli, emri i kompanisë ose organizatës, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe adresa postare.

Ju lutemi dërgoni të gjitha kërkesat për leje tek:

Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore

2011 Crystal Drive

Arlington, VA 22202

E-mail: editor@ifes.org

Faks: 202.350.6701

Çdo opinion, zbulim, konkluzion ose rekomandim i shprehur në këtë botim është ai i autorit(ve) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore.



About IFES

IFES advances democracy for a better future. We collaborate with civil society, public institutions and the private sector to build resilient democracies that deliver for everyone. As the global leader in the promotion and protection of democracy, our technical assistance and applied research develops trusted electoral bodies capable of conducting credible elections; effective and accountable governing institutions; civic and political processes in which all people can safely and equally participate; and innovative ways in which technology and data can positively serve elections and democracy. Since 1987, IFES has worked in more than 145 countries, from developing to mature democracies. IFES is a global, nonpartisan organization based in Arlington, Virginia, USA, and registered as a non-profit organization [501(c)(3)] under the United States tax code.

IFES By The Numbers



Reached 25M+
people with civic and
voter education in
2021



Supported 30
elections in
2021, training
300K+ election
officials



Worked across 58
countries in 2021


Përmbajtja

Hyrje	1
Problemet Potenciale të Parasë në Politikë	2
Centralizimi i transparencës dhe shpalosjes	3
Rregullorja zyrtare e Financave Politike	4
Zbatimi	7
Roli i Shoqërisë Civile dhe Mediave	8
Konkluzionet	10
Burimet	11

Hyrje

“Paraja është qumësht i nënës për politikë” Jesse Unruh (politikan Amerikan dhe Drejtor i Thesarit Shtetëror për Kaliforni, 1922-1987)

Figura 1: Financat politike lidhen kryesisht me aspekte kyçe të çdo shoqërie moderne



Përderisa natyra e politikave ndryshon shumë ndërmjet regjioneve dhe shteteve të ndryshme, nuk ka vend në botë ku paraja nuk është e rëndësishme në procesin e vendimmarrjes në politike.

Paraja në politikë, apo financat politike është e ndërlidhur me aspektet kyçe të çfarëdo shoqërie moderne. Menaxhimi i financave politike është i nevojshëm për zgjedhje kredibile dhe të mirëfillta dhe për fushata zgjedhore sepse ka tendencën të shtrembërojë garën në mes të garuesve. Menaxhimi i

duhur siguron që vendi të qeveriset efektshëm; sidoqoftë, korrupsioni mund shumë lehtë ta dëmtojë qeverisjen e mirë.

Një shoqëri demokratike kërkon dialog të vazhdueshëm me qytetaret e sajë, proces i cili kërkon financim. Shqetësimi është që paraja mund t'i bëjë politikanët të përgjegjshëm më shumë ndaj kontribuesve sesa ndaj votuesve. Qasja ndaj financimeve të pa korruptuara dhe ligjore redukton tundimin e politikanëve, partive politike dhe shërbyesve civil për të angazhuar qasje të korruptuar – por që vet ekzistenca e parasë në politike mund ta krijojë këtë risk.

Po të ishte paraja e nevojshme, ani pse pjesë problematike e politikës, ne duhet ta kemi parasysh mënyrën se si mund ta kontrollojmë ndikimin në mënyrë që të ushqejmë aspektet pozitive të sajë duke kontrolluar dhe reaguuar ndaj ndikimeve negative. Nuk ka ndonjë model të përgjithshëm që do të përshtatej për të gjitha vendet. Qëllimet dhe problemet që vende individuale do të dëshironin t'i adresonin duhet patjetër të vlerësohen duke u bazuar në kontekst. Kjo nuk nënkupton që secili vend nuk mund të përpilojë mësim nga eksperiencat e të tjerëve.

Përmbledhje

Kjo përmbledhje ofron një hyrje në problemet dhe zgjidhjet kyçe lidhur me financat politike. Përderisa ka shumë probleme të mundshme, ne kemi vendosur ta vëmë theksin në abuzimin e burimeve shtetërore për të treguar vështirësitë në rregullimin dhe luftimin e një sjellje të tillë.

Kjo përmbledhje gjithashtu adreson eksperiencën globale të rregullimit të financave politike në vende të ndryshme dhe se si rregulloret do të mund të zbatohen. Theksohen rregullat lidhur me shpalosjen (raportimin financiar); ndalesat dhe kufizimet e kontributeve dhe shpenzimeve; si dhe ofrimi i financimit publik. Rolet e

shoqërisë civile dhe mediave gjithashtu janë temë diskutimi, sikur që mësimet e nxëna globalisht në një mbikqyrje e parasë në politikë.

Në këtë dokument, ne definojmë financat politike si financa të partive politike dhe fushatave zgjedhore. Janë të mundshme definicione edhe më të gjera, duke përfshirë sjelljen e zyrtarëve të zgjedhur dhe situatat e konfliktit të interesit të cilat i hasin politikanët dhe shërbyesit civil lidhur me paranë në politikë.

Problemet Potenciale të Parasë në Politikë

Siç u përmend, paraja është një aspekt i nevojshëm i politikës moderne, por që gjithashtu krijon sfida për demokracinë në mbarë botën. Në një mënyrë ose tjetër, këto probleme ndërlidhen me thyerjen e lidhjes në mes të votuesve dhe të përzgjedhurve apo atyre që pretendojnë përzgjedhjen. Problemet tipike dallojnë ndërmjet regjioneve dhe shteteve të ndryshme. Më poshtë i keni disa nga sfidat më të shpeshta.

Interesat e të Pasurve mund të Përfitojnë Ndikim të Padrejtë ndaj Sistemit Politik

Përderisa “një person, një votë” është një princip i vendosur i zgjedhjeve në mbarë botën, dallimet në burime mund të bëjnë që disa zëra të dëgohen më shumë se të tjerët. Të tillët me para mund të ndikojnë tek politikanët dhe vendimet e politikanëve në mënyra që paraqesin probleme për demokracinë.

Kontributet për Fushatë nga Biznese Mund të Shpiejnë tek Korrupsioni në Financat Publike

Shumë vende lejojnë kompanitë private të japin donacione për parti politike dhe fushata zgjedhore. Sidoqoftë, në shumë vende ekziston frika që politikanët mund të japin trajtime preferenciale për korporatat nga të cilat kanë marrë mbështetje. Kjo mund të ketë ndikim negativ në prokurimin publik dhe iniciativat zhvilluese, dhe jo vetëm që mund të lëndojë demokracinë, por gjithashtu edhe efektshmërinë e administrimit dhe qeverisjes.

Abuzimi me Burimet Shtetërore

Në shumë vende të botës, partitë politike në qeveri abuzojnë me qasjen e tyre tek burimet Shtetërore për t'u siguruar qëndrimin e tyre në pushtet. Kjo çështje diskutohet më tutje në këtë raport.

Financimi i Paligjshëm dhe Ndikimi në Politikë

Një problem në rritje në disa vende të botës është ndikimi i fondeve të paligjshme në politikë. Ndonjëherë kriminelët dëshirojnë të hyjnë në qeveri për të fituar imunitet, dhe në raste të tjera, fushatat zgjedhore bëjnë shpërlarjen e parasë. Kriminelët gjithashtu mund të përdorin donacionet për të ushtruar ndikim tek politikanët për shmangje të hetimeve në veprimet e tyre të paligjshme.

Ndikimi i Financimit të Jashtëm Mund të Kanos Sovranitetin e Politikave

Kombëtare

Edhe në botën tonë gjithnjë e më shumë të globalizuar, çdo vend mbron institucionet e veta politike, siç janë organet kombëtare dhe lokale. Në qoftë se paraja nga jashtë përdoret për fushata zgjedhore, politikanët mund të marrin në konsideratë më shumë interesat nga jashtë vendit sesa interesat e votuesve. Nëse kjo përhapet, mund të kanoset sovraniteti i vendeve.

Shpenzimet e Mëdha për Fushata mund ta Vështirësojnë Shfaqjen e Forcave të

Reja Politike

Edhe nëse asnjë donator nuk ka ndikim të paligjshëm mbi procesin politik – dhe nuk janë përdorur fonde të paligjshme, të jashtme apo të tjera – paraja prapë se prap mund të ketë ndikim negativ. Në qoftë se forcat e reja politike nuk mund të arrijnë t'i bëjnë zërat e tyre të dëgjohen për shkak se kosto e fushatës është shumë e lartë, sistemi politik nuk do të jetë në gjendje të adaptohet ndaj ndryshimeve në mendimin popullor. Kostoja e lartë e fushatës shumë shpesh është njëri ndër problemet me të cilat gratë që dëshirojnë të kyçen në politikë ballafaqohen, duke qenë që gratë kanë nivel më të ulët të qasjes në rrjete të palëve të pasura.

Blerja e votës

Përpjekjet për të fituar zgjedhjet nëpërmjet shpenzimeve jo nëpërmjet mbështetjes nga populli, janë shumë të shpeshta në shumë vende të botës. Ndonjëherë blerja e votës merr formën e një transaksioni direkt, ku votues individual pranojnë para nëse dëshmojnë se kanë votuar në një mënyrë të caktuar, e kjo përfshinë fotografimi i fletëvotimit me telefon. Ndonjëherë blerja e votës është indirekte dhe e përbashkët, duke përfshirë kur komuniteti apo udhëheqësve fetar iu epet mundësia për ndikim në vota tek ndjekësit e tyre. Në çfarëdo rasti, blerja e votës mund të bëhet një interferencë për zgjedhje demokratike.

Centralizimi i transparencës dhe shpalosjes

Transparenca në financat politike është krijuar nga Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara (UNCAC), e cila thekson që të gjitha vendet do duhej të “konsideronin ndërmarrjen e masave të duhura legjislative dhe administrative, në konsistencë me objektivat e kësaj Konvente dhe në përputhje me parimet bazë të ligjit të tyre vendor, për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për pozita publike që garojnë dhe, aty ku aplikohet, financimin e partive politike.”¹

Informacionet e gatshme lidhur me financat e aktorëve politik, veçanërisht atyre të partive politike dhe kandidatëve për pozita publike, është kyçe në çfarëdo sistemi efektiv të kontrollit të financave politike. Pa atë njohuri, shumë shpesh është e pamundur të dihet nëse forma të tjera rregulloreve janë duke u respektuar.

¹ UNCAC Neni 7(3).

Sidoqoftë, jo të gjitha vendet kanë paraqitur rregullore të tilla. Figura 2 tregon pjesën e vendeve në raport global të cilat kanë krijuar kërkesat e raportimit formal për partitë politike dhe kandidatët zgjedhor (të dhënat nga mesi i vitit 2022).² Posedimi i rregullave të cilat kërkojnë raportim nuk nënkupton gjithsesi që raportet e dorëzuara janë të sakta, apo që raportet auditohen me kujdes.

Ka një numër çështjesh që duhet të merren parasysh gjatë dizajnit të një sistemi për raportim nga akterët politikë. Sistemi duhet të jetë i përshtatshëm ndaj situatës për çdo vend. Për shembull, sistemi do të llogariste se sa mire është i krijuar sistemi bankar dhe kapacitetin e partive/kandidatëve politikë për t'iu përmbajtur.

Rregullat për raportim financiar nuk duhet të jenë shumë të komplikuar e që akterët s'do të mund t'iu përmbaheshin.

Përderisa diskutohet që shpalsja publike mund t'i bëjë donatorët më pak të interesuar për ofrim fondesh ndaj partive opozitare dhe kandidatëve, që si pasojë mund të bëjë rritjen e avantazhit për mbajtje të postit, kjo do duhej të matej kundrejt të së drejtës së elektoratit të dijë lidhur me marrëveshjet financiare të atyre që dëshirojnë të përfaqësojnë atë.

Sistemi për raportim, rishikim dhe publikim të të dhënave të financave politike patjetër që duhet gjithashtu të përshtatet me situatën e secilit vend. Në shumë kontekste, zgjidhjet elektronike, që në mënyrë ideale përfshijnë publikimin e databazës së qasshme dhe me mundësi kërkimi, mund ta rrisin dukshëm transparencën se si partitë dhe kandidatët rrisin dhe pranojnë fonde pa vënë ngarkesa të panevojshme administrative për ata që kërkohet të dorëzojnë raporte ose për organin apo organet zyrtare të mbikëqyrjes.

Rregullorja zyrtare e Financave Politike

“Në një shtet ku korrupsioni është me bollëk, ligjet duhet të jenë shumëta” Tacitus
(Historian Romak, 55-120 AD)

Mënyra më e zakonshme e adresimit të sjelljeve ta pa dëshiruara lidhur me paranë në politikë është hyrja në fuqi e ligjeve dhe rregulloreve. Rregullat e shpalsjes (raportimit financiar) kanë për qëllim të arrijnë transparencën. Ndalesat dhe kufizimet kanë për qëllim që të heqin direkt disa lloje të sjelljeve. Financimi publik shpesh ofrohet për të reduktuar varësinë e partive politike dhe kandidatëve ndaj parasë private. Ka edhe forma tjera të

Figura 2: Kërkesat për Shpalsje në Regjione të Ndryshme

Regjioni	Partitë politike (vjetore/në raport me zgjedhjet)	Kandidatët
Afrikë	85%/65%	59%
Amerikat	67%/71%	63%
Azi	91%/65%	86%
Evropë	96%/75%	84%
Oqeania	37%/37%	57%
Botë	82%/66%	72%


² Të dhënat nga IDEA Ndërkombëtare (fillimisht hartuar në vitin 2012) shih “Burimet.”

rregulloreve të financave politike. Rregullat që lidhen me abuzimin e burimeve shtetërore dhe media, dhe rregullave që kufizojnë periudhën përgjatë së cilës fondet e fushatës mund të shpenzohen nëpërmjet themelimit të një periudhe të fushatës zyrtare janë disa shembuj. Cilat do që të jenë rregullat e zgjedhura, ato duhet të jenë të përshtatshme për situatën dhe qëllimet e secilit vend.

Ndalesat dhe kufizimet lidhur me Kontributet dhe Shpenzimet

Ndonjëherë thuhet që përderisa financat e partive politike dhe kandidatëve janë të hapura dhe transparente, nuk ka nevojë për rregullore shtesë. Nocioni është i tillë që elektorati do të marr vendimet e veta duke u bazuar në informacionin që është në dispozicionin e tyre. Për shembull në qoftë se një parti shpenzon shumë në dhurata, elektorati mund ta ndëshkojë këtë qasje populiste duke refuzuar që ta rizgjedh përsëri këtë parti.

Figura 3: Llojet e ndalesave lidhur me kontributet dhe shpenzimet



Sidoqoftë, ka një arsye pse të besohet që një qasje e tillë nuk është në fuqi askund. Aty ku hapësira në qasje është e madhe, apo ku mediat nuk e kanë lirinë e plotë, mund të jetë e vështirë që informacioni lidhur me financat politike të arrijë tek elektorati. Në situata të tilla, rregulloret duhet të targetojnë sjelljen e partive politike dhe kandidatëve, jo vetëm informacionin në dispozicion për një sjellje të tillë.

Një mënyrë e luftimit të sjelljes së padëshiruar është vendosja e ndalesave. Këto ndalesa mund të përdoren për të ndaluar aktorët politikë nga pranimi i fondeve nga burime të "padëshiruara", siç janë të huajt. Databaza e IDEA-s Ndërkombëtare lidhur me rregulloret e financave politike tregon që 70 përqind nga 179 vende që kanë pasur të dhëna në dispozicion kanë ndaluar kontributet nga burime të huaja.³ Disa vende iu ndalojnë korporatave të kontribuojnë për fushata. Zakonisht arsyetimi për këtë është që korporatat mund të ndikojnë në sjelljen e aktorëve politik. Në vitin 2022, 28 përqind nga 177 vende me të dhëna në dispozicion kanë ndaluar kontributet e tilla. Ndalimi i kontributeve nga financimi publik, me përjashtim të provizioneve rregullative për financim publik, është njëra ndër mënyrat e luftimit të abuzimit me burime shtetërore.

Shume vende ndalojnë donacionet anonime në baza të asaj se po qe se lejohen donacione të tilla, do të jetë e pamundur të verifikohet nëse ndalesat për shembull për donacione nga jashtë apo korporata përkrahen. Sipas bazës së të dhënave të IDEA-s, 73 përqind nga 177 vende për të cilat të dhënat janë në dispozicion përdorin një

³ Të dhënat nga IDEA Ndërkombëtare (2012), nga mesi i vitit 2022. shiko "Burimet". Një çështje nganjëherë e diskutueshme është nëse qytetarët që banojnë jashtë vendit duhet të lejohen të kontribuojnë në fushatat zgjedhore. Ky mund të duket një parim i arsyeshëm, por në shumë vende, qytetarët që banojnë jashtë vendit nuk kanë të drejtë vote. Është shumë e vështirë të konfirmohet që donacionet që vijnë nga jashtë vendit vijnë nga një qytetar dhe jo nga interesa të huaja.

ndales komplet apo kufizim specifik për donacione anonime, duke e bërë llojin më të zakonshëm të kontributit të ndaluar.

Ndalesat në shpenzime mund të kenë cak vese të dukshme si blerjen e votës apo korrupsionin e zyrtarëve zgjedhor. Sidoqoftë, disa vende përdorin ndalesa për të arritur qëllime të tjera, siç janë nivelizimin e hapësirës së fushatës zgjedhore duke ndaluar aktivitete si p.sh. reklamimin privat. Ndalesat në reklamim, të kombinuara me provizionin e qasjes së lirë dhe të barabartë ndaj mediave të shtypura dhe transmetuese, ndonjëherë shihen si një mënyrë e kufizimit të avantazheve ndaj garuesve më të pasur. Kritikët argumentojnë që rregulla të tilla mund të pengojnë lirinë e shprehjes.

Në situata të caktuara, vendet mund të mos duan të ndalojnë aktivitete të caktuara në tërësi, por më shumë t'i reduktojnë ato nëpërmjet imponimit të kufizimeve. Duke kufizuar shumat të cilat njerëzit apo kompanitë do të mund të kontribuonin, disa vende shpresojnë të reduktojnë riskun e donacioneve të mëdha që ndikojnë vendimet e politikanëve. Kufizime të tilla në kontribute gjithashtu mund të shtyjnë partitë politike dhe kandidatët të kenë cak grupe më të mëdha njerëzish në përpjekjet e tyre për ngritje të fondeve – një ndryshim që disa shpresojnë të sjell rritje në pjesëmarrjen e popullit në politikë.

Kufizimet mund të vendosen edhe në atë se sa mund të shpenzojnë partitë politike dhe kandidatët. Në shume vende, kufizime të tilla kanë për qëllim nivelimin fushëbetejën në mes të konkurrentëve të pasur dhe të varfër, por kufizimet kanë për qëllim gjithashtu të reduktojnë shpenzimet në fushatat zgjedhore në përgjithësi, nëse konsiderohet se shpenzime të tilla janë të tepërta në raport me ekonominë vendore ose nivele të varfërisë. Të dhënat nga IDEA Ndërkombëtare për bazën e të dhënave për financat politike tregojnë që rreth 30 përqind e vendeve imponojnë kufizimet e shpenzimeve për partitë politike dhe 48 përqind për kandidatët.

Ndalesat dhe kufizimet për kontribute dhe shpenzime mund të jenë një mjet i kontrollit të parasë në politikë. Sidoqoftë, pak ka domethënie prezantimi i një rregullore të tillë përveç nëse ka një sistem funksional të raportimit, duke përfshirë një proces efektiv për detektim dhe sanksionim të shkeljeve të ndalesave dhe kufizimeve. Thjesht imponimi i kufizimeve ka pak gjasa të ketë ndonjë efekt nëse personat e përfshirë ndiejnë kërcënim që shkeljet do të penalizohen.⁴

Financimi publik i Partive Politike dhe Kandidatëve për Zgjedhje

Format e rregulloreve të diskutuara më lartë ndërlidhen me tentimet e parandalimit apo sanksionimit të llojeve të caktuara të sjelljeve.⁵ Ashtu siç është theksuar në hyrje, sidoqoftë, ne duhet të kemi parasysh që paraja është pjesë e nevojshme e politikës, dhe provizioni i parasë të “pastër” apo të “rregulluar” nga buxheti i Shtetit mund të ndihmojë në reduktimin e ndikimit negativ të parasë në politikë pa kufizuar dialogun e shëndosh dhe garën.

Ofrimi i parasë publike për partitë politike dhe (më pak e zakonshme) kandidatëve për poste publike është përdorur në disa vende të Amerikës Latine në vitet e hershme të 1920-tave; dhe pastaj është paraqitur në Evropë në vitet e 1960-ta. Tani përdoret në të gjitha regionet në dy-të-tretat e shteteve të botës.

⁴ Mënyra më efektive për të siguruar pajtueshmërinë me kufijtë e shpenzimeve është përcaktimi i kufirit aq i lartë sa askush nuk mund ta arrijë atë. Sidoqoftë, kjo do të heqë çdo qëllim të rregullores.

⁵ Kjo pjesë bazohet në kapitullin e financimit publik në Rregullimin e Financave Politike, Përvoja Globale (2009) dhe hulumtimet që janë në vazhdim.

Përkrahësit e financimit publik argumentojnë që kjo do të ndihmonte edhe fushën politike dhe do t'iu jepte zë forcave të reja dhe të vogla politike. Gjithashtu pretendojnë që do të ndihmonte reduktimin e tundimit të politikanëve për praninë të donacioneve ilegale apo abuzimin me burime shtetërore. Kritikët druajnë që provizioni i financimit publik mund të reduktojë lidhjen në mes të politikanëve dhe mbështetësve, dhe do të bënte partitë politike më shumë pjesë të shtetit sesa të shoqërisë. Ata gjithashtu pohojnë se nëse financime të tilla janë në dispozicion për partitë që tanimë janë të përfaqësuara në qeveri, do ta bënte më të vështirë për partitë e reja ta garonin.


Ka një numër të madh të çështjeve për t'i adresuar gjatë dizajnit të sistemit të financimit publik. Aty përfshihen:

- Pragu për kualifikim (kujt i lejohet të ketë qasje në financim)
- Kriteret e ndarjes (të gjithë të kualifikuarve do tu jepej shuma e njejtë apo sasia e fondeve do varej nga mbështetja e dëshmuar popullore)
- Koha e mbështetjes (para apo pas zgjedhjeve ose vjetore)
- Forma e mbështetjes publike (me para të gatshme apo financim indirekt si përshembull lirim nga tatimi apo qasje në media).

Zbatimi

“Shumë rregulla. Shumë pak zbatim”⁶ Michael Pinto-Duschinsky (Studies i Financave Politike)

Figura 4: Struktura e Zbatimit



Rregulloret formale, siç janë ato të diskutuara, mund të ndihmojnë të kundërveprojnë ndikimin negativ të parasë në politikë. Sidoqoftë, kjo është e vërtetë nëse rregulloret të tilla zbatohen në praktikë. Kërkesat për raportim dhe rregulloret të tjera formale janë të nevojshme, por sigurisht jo të mjaftueshme për të arritur transparencën e financave politike.

Është shumë me rëndësi të theksohet që zbatimi është një çështje jo vetëm në demokracitë në zhvillim. Ashtu siç thekson Hani Zainulbhai në publikim e IFES-it të vitit 2009 *Rregullimi i Financave Politike, Eksperiencia Globale* në kapitullin Zgjidhjet Praktike për Zbatim dhe Mbikëqyrje, “Në sisteme ku institucionet janë më të forta, lojtarët politikë janë aftësuar në shmangien e ligjit. Përdorimi i teknikave si llogaridhënia e dyfishtë dhe besimi në shpenzime të pavarura janë të zakonshme.”⁷

⁶ Pinto-Duschinsky, Michael. Seritë e Marrjes së Demokracisë Seriozisht, Nr. 1. *Financat Politike Shtetërore*. Sekretariati Shtetëror, Londër, 2001. faqe 25.

⁷ Ohman, Magnus & Zainulbhai, Hani. *Rregullimi i Financave Politike, Eksperiencia Globale. Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore*, Washington, 2009.

Një rekomandim i përgjithshëm për zbatim të efektshëm është që agjensionet e përgjegjshme duhet të kenë një mandat të qartë dhe kapacitet të detektojnë shkeljet dhe të zbatojnë rregulloret ekzistuese. Në shumë vende, trupi menaxhues zgjedhor ka përgjegjësinë për të monitoruar financat politike; sidoqoftë, organi mbikëqyrës mund të jetë gjithashtu edhe komision për partitë politike, një institucion i auditimit apo gjykate.

Sido qoftë struktura, agjensioni caktohet të mbikëqyr individë dhe subjekte që shpesh janë politikan senior, parti politike në qeverisje dhe shpesh kryetari i shtetit. Si rezultat, mund të përjetojë presion të mos hetojë regjistrat financiare me shumë kujdes. Për një person që punon në mbikëqyrje të financave politike, marrja seriozisht e punës mund t'ia rrezikojë karrierën. Strukturat e emërimit për udhëheqës të agjensioneve bëhen shumë të rëndësishme, ashtu siç bëhet edhe kontrolli që agjensioni bën për buxhetin e vet.

Për të qenë efektiv, agjensioni për zbatim duhet patjetër të ketë qasje në sanksionet efektive. Sanksionet efektive do duhej të ishin në dispozicion, duke variuar nga penalizime të lehta administrative për shkelje të vogla – siç është vonimi i dorëzimit të pasqyrave financiare – deri tek refuzimi i partive politike ose kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje. Refuzimi i pjesëmarrjes mund të jetë meritator në rast të refuzimit të plotë për t'iu bindur kërkesave të raportimit. Si hap final, shpërbërja e një partie politike mund të ndodh nëse zbulohet vërtetimi dhe përsëritja e keq menaxhimit financiar (siç është blerja e votës ose abuzimi me burime shtetërore). Sanksione të tilla mund të përfshijnë vazhdimësitë civile ose kriminale. Sidoqoftë qasja është qenësore që partia e afektuar ka të drejtën të apelojë për vendimet dhe procesi respekton sundimin e ligjit.

Sidoqoftë nuk mund të theksohet qartë që, përveç mandatit të qartë ligjor dhe kapacitetit të nevojshëm teknik, organi për zbatim duhet të ketë pavarësi politike dhe dëshirë politike për të zbatuar legjislacionin ekzistues. Në mungesë të këtyre tipareve, çfarëdo forme rregullative ka gjasa të injorohet.

Roli i Shoqërisë Civile dhe Mediave

“Sekreti i kryerjes së punëve është të veprosh!” Dante Alighieri (Poet italian, 1265-1321)

Përderisa rregulloret formale të cilat zbatohen nga institucione shtetërore janë të rëndësishme për kontroll të parasë në politikë, eksperiencia tregon që në një vakum kurrë nuk është e mjaftueshme. Akterë të tjerë duhet të marrin rol aktiv në mbikëqyrjen se si rrjedhë paraja nëpër sistemin politik. Politikanët dhe partitë politike natyrshëm kanë një rol crucial për të vepruar përgjegjshëm, por përpjekjet për të rritur transparencën në financat politike nuk mund të presin derisa të përfshirët ndryshojnë sjelljet e tyre

Shoqëria civile

Akterët e shoqërisë civile kanë role kyçe në përmirësimin e kontrollit të parasë në politikë. Ata duhet të sigurohen që njerëzit janë të vetëdijshëm për aspektet negative të blerjes së votës, abuzimin me burime shtetërore dhe rregullat në secilin vend. Ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e sjelljes së partive politike dhe kandidatëve në atë mënyrë që institucionet shtetërore mund të mos kenë kapacitet apo pavarësinë për të vepruar. Projekte të tilla janë kryer në shumë vende, dhe grupe vëzhguesish vendor të zgjedhjeve janë në rritje duke futur financat politike në grupin e çështjeve të adresuara nga puna e tyre (ta keni parasysh që monitorimi i financave politike duhet gjithnjë të fillojë shumë përpara ditës së votimit).

Figura 5: Rolet e Shoqërisë Civile në Rritjen e Transparencës në Financa Politike



zgjedhjeve janë në rritje duke futur financat politike në grupin e çështjeve të adresuara nga puna e tyre (ta keni parasysh që monitorimi i financave politike duhet gjithnjë të fillojë shumë përpara ditës së votimit).

Mediat

Mediat, tradicionale dhe të reja, kanë përgjegjësi në sigurimin që njerëzit të e dinë se nga i marrin paratë politikanët dhe se si i përdorin. Duke shfaqur sjelljen jo të mirë dhe shkeljet e rregullave formale dhe normave shoqërore, mediat mund të ndihmojnë në denimin e atyre që tentojnë të zëvendësojnë mungesën e mbështetjes popullore me para në garë për pushtet politik.

Një faktorë që theksohet si forcë shtytëse mbrapa reformës rregullative është skandali. Edhe pse skandalet nuk mund të shpjegojnë emergjencën e reformave të financave politike në të gjitha rastet, mund të jetë një forcë shtytëse e rëndësishme për ndryshim. Nëse njerëzit janë mjaftë të inatosur me shkeljet e fushatës së rregulloreve financiare, ata mund të kërkojnë të bëhet diçka për t'a parandaluar shkeljet që të mos ndodhin më në të ardhmen. Ish Drejtori për Degën e Shkeljeve Zgjedhore në Departamentin e Drejtësisë, Craig Donsanto ka theksuar që “reagimi i një vendi ndaj skandaleve të financave publike është determinues i rëndësishëm për të përcaktuar fuqinë e institucioneve demokratike.”⁸

Në mënyrë që të bëhen përparime afat-gjata, është e rëndësishme që mediat jo vetëm të kenë fokus në skandale individuale, por gjithashtu me kujdes të përcjellin çfarëdo përpjekje të bërë për të përmirësuar situatën. Nuk është e pazakontë që politikanët të premtojnë reforma para zgjedhjeve dhe të harrojnë premtimet e bëra pas Ditës së Zgjedhjeve.

⁸ Donsanto, Craig. “Nga Kriza në Reforma, një Perspektivë Historike” në *Demokrati në Përgjithësi*, Vol 2, Nr 4 2006, faqe 11.

Konkluzionet

“Para s’do të krijojë sukses, liria për të krijuar do ta bëjë” Nelson Mandela (Ish President i Afrikës së Jugut)

Disa vite më parë, IFES-i dhe disa organizata të tjera kanë identifikuar mësimet e nxëna nga puna në çështje të kontrollit dhe transparencën të financave politike përgjat dekadave të fundit. Përderisa eksperiencat janë të ndryshme nga regjioni në regjion dhe vendi në vend (dhe sigurisht përgjatë periudhave kohore), janë identifikuar pesë gjëra kyçe si të qëndrueshme globalisht:

1. Paraja është e nevojshme për politikën demokratike, dhe partitë politike duhet të kenë qasje në fonde për të luajtur rolin e tyre në procese politike – rregullimi nuk duhet të ndalojë garën e shëndoshë.
2. Paraja kurrë nuk është pjesë joproblematike e sistemit politik, dhe rregullimi është i dëshirueshëm.
3. Konteksti dhe kultura politike duhet të merren parasysh gjatë përpilimit të strategjive për kontrollin e parasë në politikë.
4. Rregullimi efektiv dhe raportimi mund të ndihmojë kontrollin e efekteve të ndryshme të parasë në politikë, por vetëm nëse janë konceptuar dhe zbatuar mirë.
5. Mbikëqyrja efektive varet në aktivitetet dhe interaktivitetin e disa akterëve (siç janë rregulluesit, shoqëria civile dhe mediat) duke u bazuar në transparencë.

Pavarësisht nga ajo çfarë u tha më lartë, është me rëndësi të kuptohet që arritja e një mbikëqyrje efektive për financat politike (mbikëqyrje totale asnjëherë nuk është e mundur) mund të zgjat me dekada, jo me vite. Kushdo që vendos të rris transparencën lidhur me parën në politikë duhet të ketë durim dhe të pres të ketë punë përgjatë një kohe të gjatë.

Sidoqoftë, dështimi për të adresuar këtë çështje rrezikon sistemin politik që nuk kontrollohet me votë, por me para. Kontrolli efektiv i parasë në politikë mund të vijë vetëm nëpërmjet një përpjekje rigoroze dhe të vazhdueshme nga të gjithë akterët.

Burimet

Përmbajtja në internet e IFES për financat politike, në dispozicion në <http://ifes.org/issues/political-finance>

Përmbajtja në internet e IFES në lidhje me abuzimin e burimeve shtetërore, në dispozicion në <http://www.ifes.org/abuse-state-resources>

Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO) Analiza e rregulloreve të financave politike në rajonin e Këshillit të Evropës. Mund t'a gjeni në: <https://www.coe.int/en/web/greco/evaluations/round-3>

Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (2018) *Hulumtimi i abuzimit të burimeve shtetërore dhe korniza e vlerësimit*. Mund t'a gjeni në: <http://www.ifes.org/publications/abuse-state-resources-research-and-assessment-framework>

Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (2017) *Avantazhi i padrejtë: Abuzimi i burimeve shtetërore në zgjedhje*. Mund t'a gjeni në: <http://www.ifes.org/publications/unfair-advantage-abuse-state-resources-elections>

Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (2013) *Financat Politike Doracaku i Mbikëqyrjes*. Mund t'a gjeni në: <http://ifes.org/publications/tide-political-finance-oversight-handbook>. Gjithashtu në dispozicion në Indonezisht dhe Rusisht.

IDEA Ndërkombëtare (2012) *Baza e të Dhënave për Financat Politike*. Mund t'a gjeni në: <http://www.idea.int/political-finance/>

Libraria e Kongresit (2011) *Financat e Fushatës: Një përbledhje*. Mund t'a gjeni në <http://www.loc.gov/law/help/campaign-finance/index.php>

Nassmacher, Karl-Heinz (2009) *Financimi i Garës partiake: Financimi Politik në 25 demokraci*. Nomos.

Ohman, Magnus & Zainulbhai, Hani (eds) (2009) *Rregullimi i Financave Politike, Eksperiencat Globale*. Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore, Ëashington. Në dispozicion në gjuhën Angleze, Dari, Franqeze, Pashto dhe Rusisht.

Iniciativa e Drejtësisë për Shoqëri të Hapur (2004) *Monitorimi i Financave të Fushatave Zgjedhore: Një Doracak për OJQ-të*. Mund t'a gjeni në http://www.soros.org/initiatives/justice/articles_publications/publications/monitoring_20041123

U4 Qendra Burimore për Anti-Korrupcion, *Financat Politike*. Mund t'a gjeni në <https://www.u4.no/publications/political-finance-state-control-and-civil-society-monitoring>

Transparenca Ndërkombëtare, *Blerja e ndikimit – paraja dhe zgjedhjet në Ballkan*. Mund t'a gjeni në https://www.transparency.org/whatwedo/publication/buying_influence_money_and_elections_in_the_balkans



HQ | 2011 Crystal Drive | Arlington, VA 22202 | USA

 www.IFES.org